

THE INTERNATIONAL NATIONAL POLICY SITUATION AND THE ALBANIAN DEMONSTRATIONS OF THE 1968 IN FORMER YUGOSLAVIA

Sabile Keçmezi-Basha

Abstract

After Stalin's death in Russia and many international changes in the world, many political events began to happen, which shocked many countries around the world. In the 1960's, in Western countries, the youth began to demonstrate against the capitalist system. In the United States, students demonstrated against the war in Vietnam, against racial divisions, improvement of living conditions. In Paris, the renowned philosopher Jean Paul Sartre was united with the demonstrators and together with them distributed the tracts which expressed the students' dissatisfaction, while at numerous Italian universities there were demonstrations against the new taxes for studies. In 1960, Albania, aiming to preserve its freedom and independence, seceded from the then socialist camp. The Soviet Union, in a sign of revenge, initially interrupted the aid in wheat, to force its subjection. Afterwards it interrupted the diplomatic relations as well. In 1968, Czechoslovakia, again, to maintain its freedom and independence, wanted to break away from the Socialist camp. But the forces of the Warsaw Pact led by the Soviets intervened with their armies and invaded it, thus violating the right of a people to live as they wish, by imposing the way of state organization. These were the changes that significantly affected the youth's rage against the real situation of those countries. It should be mentioned that the most massive and violent demonstrations took place in Berlin, where the students' leader Rudi Duce was wounded, which later turned into a terrorist movement led by the Bader-Meinhof tandem.

Under these tense conditions in the world, in Yugoslavia, student demonstrations were being organized as well. In Belgrade and Zagreb in 1967, were erupting powerful demonstrations. While in Kosovo, after being persuaded that a greater autonomy could not be ensured in institutional ways, in order to proclaim the Republic of Kosovo, the only remaining path were the peaceful demonstrations. The Albanian masses in Yugoslavia, through demonstrations, decided to demand the things they always lacked compared to other peoples in Yugoslavia. The demands of Albanian demonstrators, were affected among other things by how much was promised and not accomplished, with rulers going the other way. The people of Kosovo, being informed of all these events that happened in the world, did not remain indifferent. In the former Yugoslavia, people began to speak openly about constitutional changes, democratization of life, decentralization, power, etc. Either way, the Albanian people of Kosovo and other areas inhabited by Albanians had expressed their dissatisfaction, and it was quite obvious that one day it would explode. After the Fourth Plenum of the CC of LCY, Albanians began to breathe more freely, so legally the Albanian authorities asked for the equality of the Albanian people, the right for university education, faster economic development and self-administration with the many Kosovar resources. In Slovenia, more financial autonomy was demanded, while in Croatia more power. While in the world dominated the ideas of the philosopher Herbert Marcuse or communist leaders, in Kosovo in 1958, was published the novel "The Snakes of Blood" by Adem Demaçi. The novel had awakened from lethargy the Kosovo politicians. Later, the figure of Adem Demaçi would become a symbol of

national resistance, an idol for many young people, since the formation of the Revolutionary Movement for the Union of Albanians until his imprisonment and many Albanian activists and intellectuals in Kosovo.

Keywords: *Albanian activists, 1968 Demonstrations, Adem Demaçi.*

SITUATA POLITIKE KOMBËTARE E NDËRKOMBËTARE DHE DEMONSTRATAT E SHQIPTARËVE TË VITIT 1968, NË ISH- JUGOSLLAVI

Sabile Keçmezi-Basha

Abstrakt

Pas vdekjes së Stalinit në Rusi dhe shumë ndryshimeve ndërkombëtare në botë, filluan të ndodhin shumë ngjarje politike të cilat tronditën shumë shtete anë e kënd globit. Në vitet 60-të, në vendet perëndimore rinia filloi të demonstronte kundër sistemit kapitalist. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, studentët demonstruan kundër luftës në Vietnam, kundër ndasive raciale, përmirësimin e kushteve të jetesës. Në Paris, filozofi i njohur Zhan Pol Sartër ishte bashkuar me demonstruesit dhe së bashku me ta ndante traktet ku shprehej pakënaqësia e studentëve, ndërsa në universitete të shumta italiane demonstrohej kundër taksave të reja për studime. Në vitin 1960, Shqipëria, për të ruajtur lirinë dhe pavarësinë e saj, u shkëput nga kampi i atëhershëm socialist. Bashkimi Sovjetik, në shenjë hakmarrjeje, në fillim i preu ndihmat në grurë, për ta detyruar të nënshtrohej. Ndërsa më vonë kaloi në prerjen e marrëdhënieve diplomatike. Në vitin 1968, Çekosllovakia, përsëri për të ruajtur lirinë dhe pavarësinë e saj, deshë të shkëputej nga Kampi Socialist. Por forcat e Traktatit të Varshavës me në krye sovjetikët ndërhynë me ushtritë e tyre dhe e pushtuan, duke dhunuar kështu të drejtën e një populli për të jetuar si të dojë vetë, duke ia imponuar mënyrën e organizimit shtetëror. Këto ishin ato ndryshime që ndikonin dukshëm në mllëfin e rinisë ndaj gjendjes reale të atyre shteteve. Vlen të theksohet se demonstratat më masive dhe më të dhunshme ndodhën në Berlin, ku edhe u plagos lideri i studentëve Rudi Duce, të cilat më vonë u shndërruan në lëvizje terroriste të udhëhequra nga tandemi Bader-Meinhof.

Në këto kushte të tendosjes në botë, edhe në Jugosllavi kishin filluar të organizoheshin demonstrata studentore. Në Beograd dhe Zagreb më 1967 kishin shpërthyer demonstrata të fuqishme. Ndërsa në Kosovë, pasi u bindën se me rrugë institucionale nuk do të arrihej e të sigurohej një autonomi më e gjerë, që Kosova të shpallej Republikë, e vetmja rrugë që kishte mbetur ishin demonstratat paqësore. Masat shqiptare në Jugosllavi nëpërmes demonstratave vendosën që të kërkonin ato që atyre iu mungonin gjithherë në krahasim me popujt e tjerë në Jugosllavi. Tek kërkesat e demonstruesve shqiptarë, përveç të tjerash do të ndikonte edhe fakti, se sa ishte premtuar dhe çfarë nuk ishte zbatuar, por që nga pushtetarët ishte shkuar në të kundërtën. Populli i Kosovës duke u informuar për të gjitha këto ngjarje që ndodhnin në botë, ai nuk mbeti indiferent. Në ish Jugosllavi filluan flitnin hapur për ndryshime kushtetuese, për demokratizimin e jetës, decentralizimin e saj, e pushtetit etj. Edhe ashtu populli shqiptar i Kosovës dhe i viseve të tjera i banuar me shqiptarë kishte shfaqur pakënaqësinë e vet, dhe ishte krejt e natyrshme se një ditë do të shpërthente. Pas Plenumit të Katërt të KQ të LKJ-së, shqiptarët filluan të merrnin frymë më lirshëm, andaj në mënyrë legale nga pushtetarët shqiptarë u kërkuar barazia e popullit shqiptar,

e drejta për shkollim universitar, zhvillimi më i shpejtë ekonomik dhe vetë administrimi me resurset e shumta kosovare. Në Slloveni kërkohej autonomi më e madhe financiare, ndërsa në Kroaci më shumë pushtet për kroatët. Ndërsa në botë dominonin idetë e filozofit Herbert Markuze apo të liderëve komunistë, në Kosovë më 1958, u botua romani “Gjarpinjtë e gjakut”, me autor Adem Demaçin. Ngjarja e romanit kishte shkundur nga letargjia politikanët e Kosovës. Më vonë, figura e Adem Demaçit ishte bërë simbol i rezistencës kombëtare, idhull për shumë të rinj, që nga formimi i Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve e deri te burgosja e tij dhe e shumë veprimtarëve e intelektualëve shqiptarë të Kosovës.

***Fjalë kyçe:** Intelektualët shqiptarë, demonstratat e 1968, Adem Demaçi.*

Pas vdekjes së Stalinit (1953), në Rusi dhe shumë ndryshimeve ndërkombëtare në botë, filluan të ndodhin shumë ngjarje politike të cilat tronditën shumë shtete anë e kënd globit. Në vitet 60-të, në vendet perëndimore rinia filloi të demonstronte kundër sistemit kapitalist. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, studentët demonstuan kundër luftës në Vietnam, kundër ndasive raciale, përmirësimin e kushteve të jetesës. Në Paris, filozofi i njohur Zhan Pol Sartër ishte bashkuar me demonstruesit dhe së bashku me ta ndante traktet ku shprehej pakënaqësia e studentëve, ndërsa, në universitete të shumta italiane demonstrohej kundër taksave të reja për studime. Në vitin 1960, Shqipëria, për të ruajtur lirinë dhe pavarësinë e saj, u shkëput nga kampi i atëhershëm socialist. Bashkimi Sovjetik, në shenjë hakmarrjeje, në fillim i preu ndihmat në grurë, për ta detyruar të nënshtrohej. Ndërsa më vonë kaloi në prerjen e marrëdhënieve diplomatike. Në vitin 1968, Çekosllovakia, përsëri për të ruajtur lirinë dhe pavarësinë e saj, deshi të shkëputej nga Kampi Socialist. Por forcat e Traktatit të Varshavës me në krye sovjetikët ndërhynë me ushtritë e tyre dhe e pushtuan, duke dhunuar kështu të drejtën e një populli për të jetuar si të dojë vetë, duke ia imponuar mënyrën e organizimit shtetëror. Këto ishin ato ndryshime që ndikonin dukshëm në mllëfin e rinisë ndaj gjendjes reale të atyre shteteve. Vlen të theksohet se demonstratat më masive dhe më të dhunshme ndodhën në Berlin, ku edhe u plagos lideri i studentëve Rudi Duce, të cilat më vonë u shndërruan në lëvizje terroriste të udhëhequra nga tandemi Bader-Meinhof¹.

Në këto vite si ngjarje e rëndësishme ishte edhe vetëdjegia e studentit polak Jan Pallahut² si shenjë e mospajtimit me intervenimin sovjetik në Çekosllovakia.

Në këto kushte të tendosjes në botë, edhe në Jugosllavi kishin filluar të organizoheshin demonstrata studentore. Në Beograd dhe Zagreb më 1967 kishin shpërthyer demonstrata të fuqishme. Ndërsa në Kosovë, pasi u bindën se me rrugë institucionale nuk do të arrihej e të sigurohej një autonomi më e gjerë, që Kosova të shpallej Republikë, e vetmja rrugë që kishte mbetur ishin demonstratat paqësore. Masat shqiptare në Jugosllavi nëpërmes demonstratave vendosën që të kërkonin ato që atyre iu mungonin gjithherë në krahësim me popujt e tjerë në Jugosllavi. Tek kërkesat e demonstruesve shqiptarë, përveç të tjerash do të ndikonte edhe fakti, se sa ishte premtuar dhe çfarë nuk ishte zbatuar, por që nga pushtetarët ishte shkuar në të kundërtën³. Populli i Kosovës duke u informuar për të gjitha këto ngjarje që ndodhnin në botë, ai nuk mbeti indiferent. Në ish Jugosllavi, filluan hapur të flitnin për ndryshime kushtetuese, për demokratizimin e jetës, decentralizimin e pushtetit etj. Edhe ashtu populli shqiptar i Kosovës dhe

¹ Adil Pireva, *Gjashtëdhjeteteta shqiptare*, Prishtinë, Rilindja, 1994, 38-39.

² S. Novosella, *Kosova* 68, 12.

³ Shaban Braha, *Gjenocidi serbomadh*, 503.

i viseve të tjera i banuar me shqiptarë në ish-Jugosllavi, kishte shfaqur pakënaqësinë e vet, dhe ishte krejt e natyrshme se një ditë do të shpërthente.

Pas Plenumit të Katërt të KQ të LKJ-së (1966), shqiptarët filluan të merrnin frymë më lirshëm, andaj në mënyrë legale nga pushtetarët shqiptarë u kërkuar barazia e popullit shqiptar, e drejta për shkollim universitar, zhvillimi më i shpejtë ekonomik dhe vetë administrimi me resurset e shumta kosovare. Në Slloveni kërkohej autonomi më e madhe financiare, ndërsa në Kroaci më shumë pushtet për kroatët. Ndërsa në botë dominonin idetë e filozofit Herbert Markuze apo të liderëve komunistë⁴, në Kosovë më 1958, u botua romani “Gjarpinjtë e gjakut”, me autor Adem Demaçin. Ngjarja e romanit kishte shkundur nga letargjia politikanët e Kosovës. Më vonë, figura e Adem Demaçit ishte bërë simbol i rezistencës kombëtare⁵, idhull për shumë të rinj, që nga formimi i Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve e deri te burgosja e tij dhe e shumë veprimtarëve e intelektualëve shqiptarë të Kosovës.

Në këto kushte e rrethana kombëtare e ndërkombëtare kishte lindur edhe ideja për radikalizmin e kërkesave dhe metodave të veprimit. Sipas ngjarjeve që u zhvilluan më vonë, dukej se demonstratat e vitit 1968 u përgatitën me kujdes dhe për një kohë të gjatë. Ato gjetën mbështetjen dhe përkrahjen e duhur tek populli dhe rinia. Përkrahja nuk mungoi as nga intelektualët e as nga disa struktura udhëheqëse.

Që nga përfundimi i LDB, në Kosovë nuk kishte ndodhur ndonjë ngjarje që duhet shënuar, veç arrestimeve e burgosjeve të atdhetarëve që merrnin guximin që në mënyrë të hapur apo ilegale të shprehnin pakënaqësinë e tyre me okupimin. Rininë studentore nëpër metropole të botës e mundonin të tjera halle, ata luftonin për standarde e kushte më të mira studimi, e mundonte gjendja sociale apo edhe hitet e veshjet e ndryshme, ndërsa rinia e Kosovës kishte të tjera probleme. Shqiptarët në ish Jugosllavi e kishin çështjen kombëtare të pazgjidhur edhe problemet e tjera i mundonin me bollëk.

Nga të parët kishin trashëguar çështjen e pazgjidhur kombëtare, andaj ky amanet përcillej brez pas brezi e gjeneratë pas gjenerate. Të rinjtë shqiptarë kishin detyra më primare, çështja e pazgjidhur dhe e robëruar e Kosovës kërkonte angazhim të madh dhe me plot sakrifica. Të rinjtë shqiptarë kaherë kishin menduar për një demonstrim të pakënaqësisë, porse mendonin se nuk ishin pjekur kushtet, andaj reagimet e demonstratat në aspektin global pa marrë parasysh se çfarë karakteri kishin të rinjve shqiptarë iu kishin dhënë zemër.

⁴ Nebi Jashari, *Demonstratat e vitit 1968*, Forumi Ferizaj 2, 8 shtator 2012.

⁵ Sabile Keçmezi-Basha, *Me rastin e 50 - vjetorit të botimit të parë të romanit të Adem Demaçit “Gjarpinjtë e gjakut”*, Prishtinë 1958, *Karakteret historik i romanit të Adem Demaçit “Gjarpinjtë e gjakut”*, Epoka e Re”, 22.11.2008.

Kërkesat legale për Republikën e Kosovës

Pas Plenumit të Brioneve dhe pas denoncimit të hapët ndaj organeve të Sigurimit Shtetëror Jugosllav, Kosova dhe shqiptarët filluan të ndjehen më të qetë dhe më të pranuar në mënyrë institucionale. Në jetën politike të Kosovës bëhen shumë ndryshime që më parë njerëzit nuk kishin mundur as t'i merrnin me mend. Edhe në aspektin e gjyqësisë u bënë shumë ndryshime. Prokurori Krahinor, Rrezak Shala kërkoi që shumë të burgosur politik shqiptar, të lirohen menjëherë ose t'iu zvogëlohen vitet e burgut⁶.

Po në këtë vit (1968), pranë Komitetit Krahinor u formua Komisioni për ndërrime kushtetuese. Kryetar i tij ishte zgjedhur Fadil Hoxha, që njëherë ishte kryetar i Kuvendit Krahinor të Kosovës. Komisioni në atë kohë kishte për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Statutit (nga që në atë kohë Kosova kishte statut në kuadër të Kushtetutës së Serbisë) të Krahinës Autonome të Kosovës.

Në situatën e re, krahu përparimtar i kuadrove dhe i inteligjencies popullore, që tashmë pas njëmijë vuajtjesh e sakrificash, kishte arritur të dilte nga bankat e shkollave të mesme dhe të fakulteteve të ndryshme, ngre zërin edhe legalisht duke kërkuar të drejtat politike, demokratike, kulturore dhe arsimore, të sanksionuara me kushtetutë.

Pas formimit të Komisionit, në gjithë territorin e Kosovës, në aktivet politike filluan diskutimet. Kërkesat e popullit shqiptar vazhdonin me këmbëngulje, duke prekur edhe sfera të tjera të të drejtave politike e ekonomike, të cilat me decenie i ishin mohuar me dhunë. Në radhë të parë, duke u mbështetur në të gjitha tiparet dhe karakteristikat e kombit, siç janë: gjuha amtare, kultura, konstitucioni shpirtëror i përbashkët, kompaktësia territoriale, njëzëri u kërkuar që trajtimi i popullit shqiptar si “pakicë kombëtare” të avancohej në nivelin adekuat, me njohjen e statusit të kombit, ndërsa krahinës së Kosovës t'i njihej statusi i Republikës⁷. Kjo kërkesë u paraqit publikisht dhe u përkrah masivisht nga shtresat e gjera popullore. Mirëpo, punët rreth kërkesave të popullit shqiptar të Kosovës po zvarriteshin qëllimisht, qeveria e Beogradit po e bënte veshin të shurdhër e syrin qorr ndaj kërkesave të këtij populli.

Në debatet që u organizuan në aktivet politike, u angazhuan me një përkushtim të madh politikanët dhe të gjithë intelektualët shqiptarë. Në mënyra historike, të argumentuar me fakte, arsyetonin drejt se përse Kosovës duhet t'i jepet Statusi i Republikës. Lirshëm mund të thuhej se politika kosovare në atë vit ishte në avantazh. Por, reagimi i shpejtë i forcave antishqiptare serbe e malazeze me dhunë i ndërpreu diskutimet për ndryshimet kushtetuese dhe ndaj personave që u angazhuan dhe ishin të zëshëm për shpalljen e Republikës së Kosovës, u morën masa ndëshkuese.

Ndonëse, vitet 1967/68, njihen, si vite të lëvizjeve studentore në Evropë, ku universitetet më të njohura të Francës, të Gjermanisë, të Anglisë, të Italisë, po ashtu edhe në Hungari, Poloni, Çekosllovakia, Jugosllavi e vende të tjera u përfshinë në valën e trazirave studentore, megjithatë ato nuk reflektuan shumë tek lëvizja studentore shqiptare e Kosovës, për faktin se, lëvizjet studentore evropiane, kishin karakter social. Ishin lëvizje shoqërore dhe, synonin një rend më të mirë shoqëror, ndërkohë që lëvizja studentore e Kosovës, kishte karakter kombëtar, karakter të rezistencës kundër një robërie të egër shekullore.

Të rinjtë shqiptarë, kaheerë kishin menduar për një demonstrim të pakënaqësisë, por mendonin se, nuk ishin pjekur kushtet. Andaj, reagimet e demonstratat në aspektin global pa marrë parasysh se çfarë karakteri kishin, të rinjve shqiptarë iu kishin dhënë zemër. Ata, gjetën mbështetjen dhe përkrahjen e duhur tek populli dhe rinia. Përkrahja nuk mungoi as nga intelektualët e as nga disa struktura udhëheqëse.

⁶ Sabile Keçmezi-Basha, *Demonstratat studentore 1968*, Fejton Epoka e Re, nëntor 2008.

⁷ *Plenumi VII I KK të LKS-së për Kosovë e Metohi*, Prishtinë 1966, 28.

Demonstratat studentore, 1968

Në Kosovë, demonstratat e iniciuara nga grupimet e organizuara studentore, fillimisht shpërthyen në tetor (1968), si në Prizren, Pejë, Suharekë e qytete të tjera, për të vazhduar në nëntor, si: në Prishtinë, në Mitrovicë, në Gjakovë, në Gjiçan, në Ferizaj, në Podujevë dhe për të përfunduar në dhjetor 1968, në qytetin e Tetovës (Maqedoni).

Dhe, duhet shtuar, se, Demonstratat e vitit 1968, patën një rol të madh, në zhvillimet e mëvonshme politike. Ato, e detyruan udhëheqjen jugosllave, të rishqyrtojë statusin juridik të Kosovës, dhe, me këtë rast, u ndërmorën disa veprime konkrete. Në shkurt, 1969, u miratua ligji kushtetues për Kosovën, i cili hapi rrugë, që ajo, ta ketë, Kushtetutën e vet. Me anë të ligjeve emërtimi "Kosovë e Metohi" si krahinë e Serbisë, ndërron emrin në "Krahina Socialiste Autonome e Kosovës" (KSAK); Po atë vit, gjuha shqipe u sanksionua me ligj si gjuhë e dytë zyrtare, krahas gjuhës serbo-kroate; u legalizua përdorimi i flamurit kombëtar; ndërsa, në nëntor, 1969, Kuvendi i Kosovës, shpalli ligjin për themelimin e Universitetit të Kosovës, i cili, do të jetësohet më 15 shkurt 1970.

Dhe krejt në fund, të nderuar të pranishëm,

Pas debateve maratonike për ndryshimet kushtetuese (1967-1971), Kuvendi Federativ i Jugosllavisë, më 21 shkurt 1974, miraton Kushtetutën e re të RSFJ-së, ndërsa një javë më vonë, më 28 shkurt, edhe Krahina Socialiste Autonome e Kosovës, e, miraton Kushtetutën e parë të saj, e cila Kosovën e definon njëkohësisht, si: "pjesë integrale të Serbisë" dhe "element konstituiv të federatës jugosllave".